



**UNIVERSITETI I  
PRISHTINËS "HASAN  
PRISHTINA" UNIVERSITY  
OF PRISHTINA**

Rr. Xhorxh Bush, Ndërtesa e Rektoratit, 10 000 Prishtinë, Republika e  
Kosovës Tel: +381 38 244 183 · E-mail: rektorati@uni-pr.edu

---

**Fakulteti:** Bujqësisë dhe Veterinarisë

**Departamenti:** Teknologji Ushqimorë me Bioteknologji

**Programi:** MSc. Shkenca e ushqimit

**NJOFTIM**

Në bazë të rregullores për studime master të Universitetit të Prishtinës Nr. 1/334, datë 31.05.2023, Neni 12, pika 3 e kësaj rregulloreje, ju njoftojmë se :

Ekzemplari (drafti ) i temës së masterit i punuar nga kandidati/ja BSc. Ardita Saraqini, me titull:

“Analiza e preferencave dhe vlerësimit të konsumatorëve për attribute të ndryshme të mjaltit, propolisit dhe qumështit të bletës” ndodhet në diskutim publik 7 ditë nga data 12/07/2024 deri me datë 19/07/2024.

Njëkohësisht në diskutim publik ndodhet edhe raporti i vlerësimit të dorëshkrimit nga komisioni në përbërje:

1. Prof. Asoc Dr. Arbenita Hasani, mentore,
2. Prof. Asoc. Dr. Rreze Gecaj, anëtar,
3. Prof. Ass. Dr. Mentor Thaçi, anëtar

Ekzemplarin e draftit të temës dhe raportin e vlerësimit të dorëshkrimit nga komisioni mund ta kërkonte te udhëheqësi shkencor i temës Prof. Arbenita Hasani, përmes e-mail adresës arbenita.hasani@uni-pr.edu.

Për të pasur një informacion paraprak më poshtë e gjeni një përmbledhje të shkurtë përmes abstraktit të temës.

Çdo sugjerim i juaji mund të jetë një pasurim i punës tonë!

**UNIVERSITETI I PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA”**  
**FAKULTETI I BUJQËSISË DHE VETERINARISË**  
**MASTER “SHKENCA E USHQIMIT”**



**PUNIM DIPLOME**

**“Analiza e preferencave dhe vlerësimit të konsumatorëve për attribute të ndryshme të mjaltit, propolisit dhe qumështit të bletës”**

Mentorja:

**Prof. Assoc. Dr. Arbenita Hasani**

Kandidatja:

**Ardita Saraqini**

Prishtinë, Maj 2024

## **ABSTRAKTI**

Rritja e ndërgjegjësimit për mirëqenien tonë fizike dhe mendore, veçanërisht në periudhën e pandemisë, ka çuar në një interesim gjithnjë e më të madh të konsumatorëve për produkte natyrore, përfshirë mjaltin, propolisin dhe qumështin e bletës. Në këtë kontekst, kemi kryer një hulumtim me qëllim të rritjes së njohurive dhe të informacionit lidhur me cilësinë, përbërjen kimike, efektet shëndetësore dhe përdorimin e këtyre produkteve.

Synimi kryesor ishte identifikimi i preferencave të konsumatorëve dhe faktorëve që i ndikojnë ata në zgjedhjen e këtyre produkteve, si dhe promovimi i tyre si pjesë e një stili jetësor të shëndetshëm. Për të arritur këtë, u shpërnda një pyetsor online në Google Form nga janari deri në mars 2024, në të cilin morën pjesë 502 konsumatorë të përfaqësuar nga një spektër i gjerë demografik.

Të dhënat e anketës u analizuan duke përdorur paketën statistikore SPSS për të kryer lloje të ndryshme të analizave statistikore, duke përfshirë Korrelacionin Pearson, ANOVA One Way, Independent Sample T-test dhe llogaritje të tjera të ngjashme për të siguruar rezultate sa më të sakta. Rezultatet e hulumtimit treguan se konsumatorët preferojnë produktet natyrore si mjalti, propolisi dhe qumështi i bletës për përfitimet shëndetësore dhe alternativat e tyre të shëndetshme për ushqimin dhe kujdesin e trupit. Përveç kësaj, ata preferojnë blerjet drejtpërdrejt nga prodhuesit lokal për sigurinë dhe autenticitetin e produkteve. Familjet me numër më të madh anëtarësh janë më të interesuara për të paguar për produkte natyrore. Moshë dhe arsimit ndikojnë në preferencat e konsumatorëve, ndërsa dallimet mes zonave urbane dhe rurale janë të pakta. Njohuria për përfitimet shëndetësore dhe të ardhurat e familjes kanë gjithashtu një ndikim të rëndësishëm në preferencat e konsumatorëve.

Rezultatet e hulumtimit ofrojnë informacion të rëndësishëm për tregun dhe mund të ndihmojnë në përmirësimin e produktit dhe strategjive të marketingut.

**Fjalët kyçe:** *mjalti, propolisi, qumështi i bletës, shëndeti, preferencat e konsumatorëve*

## **ABSTRACT**

The growing awareness of our physical and mental well-being, especially during the pandemic, has led to an increasing interest among consumers in natural products, including honey, propolis, and bee milk. In this context, we conducted a study aimed at enhancing knowledge and information regarding the quality, chemical composition, health effects, and use of these products.

The main objective was to identify consumer preferences and the factors influencing their choice of these products, as well as promoting them as part of a healthy lifestyle. To achieve this, an online questionnaire was distributed via Google Form from January to March 2024, with the participation of 502 consumers representing a wide demographic spectrum.

The survey data were analyzed using the SPSS statistical package to perform various types of statistical analyses, including Pearson Correlation, ANOVA One Way, Independent Sample T-test, and similar computations to ensure the most accurate results. The research findings showed that consumers prefer natural products such as honey, propolis, and bee milk for their health benefits and healthy alternatives for nutrition and body care. Furthermore, they prefer direct purchases from local producers for the safety and authenticity of the products. Families with a larger number of members are more interested in paying for natural products. Age and education influence consumer preferences, while differences between urban and rural areas are minimal. Knowledge of health benefits and family income also has a significant impact on consumer preferences.

The research results provide valuable information for the market and can help improve product and marketing strategies.

**Keywords:** *honey, propolis, bee milk (royal jelly), health, consumer preferences*